



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ prot.

Gramsh, më 20.12.2021

Lënda: Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak, për lëvizjen paralele në kategorinë e ulët drejtuese, për vendet e shpallura të lira me njoftimin nr.4616, datë 07.12.2021, pozicioni "përgjegjës i sektorit të buxhetit".

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Adresa: Bulevardi "B.Curri" pranë ish-Hotel "Arbana"

TIRANË

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit dhe verifikimit paraprak, të aplikimeve të dorëzuara pranë zyrës së protokoll-arkivit, për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil, për vendet e shpallura të lira me Njoftimin nr.4616, datë 07.12.2021, Njësia Përgjegjëse, Ju dërgon listën e kandidatëve nr. 4814, datë 20.12.2021 "Rezultati i verifikimit paraprak për lëvizjen paralele në kategorinë e ulët drejtuese (përgjegjës i sektorit të buxhetit)" që do të nënshtrohen fazës së dytë të konkurimit.

Njoftimi i shoqëruar me shkresë për sa më sipër, do t'ju nisët edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@shkp.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Klodian TAÇE

P/



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 4814 prot.

Gramsh, më 20.12.2021

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK
PËR LËVIZJEN PARALELE
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE (Përgjegjës i Sektorit të
Buxhetit)**

**Lloji i diplomës “shkencat ekonomike” niveli minimal i diplomës “Master
Shkencor”**

Në zbatim të nenit 22 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015 2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave (i ndryshuar), Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta të shpallura në Njoftimin për konkurrim nr.4616, datë 07.12.2021 “Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në shërbimin civil, kategoria e ulët drejtuese, përgjegjës i sektorit të buxhetit”, njofton se:

- Nuk ka asnjë kandidat të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të procedurës;
- Ky pozicion pune është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Afatet dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve që janë të interesuar për fazën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil, mbeten të njëjtat me ato të shpallura në njoftimin nr.4616, datë 07.12.2021, të publikuara në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqa zyrtare e bashkisë www.bashkiagramsh.gov.al dhe stenda e informimit të publikut bashkia Gramsh.

KRYETARI
Klodian TAÇE

